



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:198638
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05483839

C.nr.3050/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Diora Bajrami, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.B. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Elsig”, me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit, vlera e kontestit 2,500.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET e tërhequr padia C.nr.3050/2023 e datës 19.09.2023, parashtruar nga paditësi E.B. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Elsig”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit.

A r s y e t i m

Paditësi E.B. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij, av. B.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me dt.19.09.2023, ka parashtruar padinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Elsig”, me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit, vlera e kontestit 2,500.00 euro.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse, av. B.M. me parashtresën C.nr.3050/2023 të datës 20.03.2024, ka njoftuar gjykatën se e tërheqin padinë në këtë çështje juridike kontestimore.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet që të konstatohet e tërhequr padia e paditësit, në përputhje me nenin 261 të LPK-së. Kështu, në nenin 261 par. 1 të LPK-së theksohet që *“paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”*.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 261 dhe 387 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.3050/2023 të datës 21.03.2024

Gj y q t a r j a

Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të nenit 261 par. 4 të LPK-së.